

# Miti i “shpëtimit” të Greqisë dhe e ardhmja e botës perëndimore\*

Ylli Përmeti

**Abstrakt:** Ky studim tregon mitin që është krijuar për shpëtimin e Greqisë qoftë nga elita perëndimore e cila ka çdo arsye që t’u krijojë atë qoftë nga disa proponentë të dikur-opozitës dhe sot, të qeverisë, Syriza, arsyet se përse ajo është e tillë, qendrimet e “intelektualëve” dominantë në Perëndim për krizën që ka shpërthyer dhe të ardhmen e Perëndimit në përgjithësi.

## Miti i “shpëtimit” të Greqisë dhe e ardhmja e botës perëndimore

Një mit tjetër është krijuar në sferën Europiane në lidhje me “shpëtimin” “nga brenda” të Greqisë: se Europeanët verior po shpëtojnë jugorët! Angela Merkel, për shembull, pretendon se taksapaguesit Gjermanë do të jenë viktimat kryesorë për çdo rinegociim të borxhit grek, meqëse Gjermania ka dhënë 20% nga ai, dhe Ministri i financës Wolfgang Schauble ka përsëritur se ajo nuk do t’u pranonte atë. Sidoqoftë, pikëpamja mbizotëruese Gjermane është se “Grexit” do të jetë një gjëmë për Greqinë, një tronditje e vogël për eurozonën dhe një jongjarje për ekonominë botërore.<sup>1</sup> Nga perspektiva e Brukselit, Greqia, siç citon një analist, ‘duhet të varroset dhe të shihet se si varroset. Sepse kështu shtete të tjerë të eurozonës që kanë vuajtur nga trajtimi i trojkës do të kuptojnë idetë’.<sup>2</sup> Por borxhet e dhënë nga eurozona dhe FMN-ja të cilët përlllogariten në sasinë prej €226.7miliard (rreth 125 për qind e GDP-së) — afërsisht sa dy e treta borxhit total publik prej 175 për qind të PBB-së...shkuan kryesisht jo për të përfituar Grekët por për t’iu shmangur shënimit të borxheve të këqij për qeverinë dhe bankat Greke. Vetëm 11 për qind e borxhit financoi drejtpërdrejt veprimtaritë e qeverisë. Një tjetër përqindje prej 16 për qind u përdor për pagimin e interesave. Pjesa tjetër shkoi për operacione kapitale të llojeve të ndryshme: kështu, paraja hyri në Greqi dhe pastaj doli jashtë sërish.<sup>3</sup> FMN-ja, për shembull, ka fituar nga borxhet dhe interesi prej 3.6% që i ka dhënë Greqisë 2.5 miliard euro pesë vitet e fundit. Nga të gjithë vendet që gjenden në krizë nga viti 2010 deri në vitin 2014 - FMN-ja ka kryer përfitime prej 8.4 miliard euro.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Grexit is an avoidable catastrophe for the eurozone, *Wolfgang Münchau, FT*, February 1, 2015.

<sup>2</sup> The case for radical change in Europe can’t be left to the nationalists right, *Seumas Milne, The Guardian*, 10 June 2015.

<sup>3</sup> Greek debt and a default of statesmanship, *Martin Wolf, FT*, January 27, 2015.

<sup>4</sup> The IMF has made €2.5 billion profit out of Greece loans, *Global Research*, July 06, 2015.

Borxhet, në fjalë të tjera, janë dhënë për të dalë jashtë vendit sërish. Ndërsa kjo është gjysma e të vërtetës, atje është gjysmë tjetër — se Gjermania ka fituar sasi të mëdha nga pozicioni i saj në BE. Siç analizon *Reuter*:

*Nga shpëtimet nga jashtë e një totali prej më shumë se 400 miliard euro, taksapaguesit verior të eurozonës nuk kanë paguar në të vërtetë asnjë qindarkë...përkundrazi: Berlina kurseu 10.2 miliard euro në vitin 2010-2012 për shkak të kostove të ulëta huamarrëse, meqëse interesi mbi bondet e saj 10 vjeçarë ra nga 3.30 për qind në 1.18 për qind (Allianz)...buxheti federal Gjerman kurseu 8.6 miliard euro në vitin 2011 për shkak të përqindjeve të ulëta të interesit dhe nga ndikimi mbrojtës i investitorëve që depozitonin pará në Gjermani (Jens Boysen-Hogrefe of the IfW economic institute). Ato kursime u rritën në 9.6 miliard në vitin 2012 dhe ndikimi mbrojtës do të ketë vlerën 2 miliard në vitin 2013. Nëse ne shtojmë avantazhet e përqindjes së interesit në periudhën e vitit 2010-2012 dhe ato që Gjermania do të përfitojë në vitet që do të vijin, në arrijmë në një lehtësim interesi mbledhës për buxhetin e Gjermanisë prej 67 miliard euro. Shkurt, përveç borxheve fillestarë bilateral të dhëna Greqisë në vitin 2010 të cilët shkuan 52.9 miliard euro, asnjë qindarkë e taksapaguesve të eurozonës nuk ishte dërguar në Greqi, ose në çdo vend tjetër. **Gjithë shpëtimet e mëvonshme u financuan mbi tregun përmes fondit të shpëtimit të eurozonës.** Një studim i autorizuar nga Fondacioni Gjerman Bertelsman tregoi...se nëse Gjermania do të kthehesh në Deutschmarkën e saj të vjetër, PBB-ja e saj vjetore do të ishte 0.5 pikë më poshtë midis vitit 2013 dhe 2025, duke rezultuar në një humbje prej 1.2 trilion euro për 13 vite – gjysma e madhësisë së ekonomisë Gjermane në vitin 2012.<sup>5</sup>*

Ndryshe nga kjo situatë, Varoufaki, Ministri i Financave në qeverinë e Syriza-s, ekonomisti i ndershëm i klasës së dytë dhe Marksisti “libertarian”, pak pára zgjedhjeve, në një intervistë në Radio 4, *BBC*,<sup>6</sup> mbështeti propagandën e elitës Gjermane se qytetarët European janë dëmtuar duke shpëtuar Greqinë! Siç citon ai: ithtarët e mi të shtrenjtë - problemi nuk është se ju nuk keni paguar mjaftueshëm; problemi është se ju keni paguar te...jet shumë: 240 miliard për Greqinë përgjatë pesë viteve të fundit! Sipas intervistës, Varoufaki do të sillte një plan në Bruksel dhe Berlinin me qëllim që të minimizonte koston e popujve European (Sllovakëve etj.). Për t’a realizuar atë – ai do të vinte me “reforma autentike”...me qëllim që t’i japë fund burokracisë, korrupsionit, dhe imunitetit të taksave dhe të krijojë një “plan racional” për strukturimin e borxhit! Në të vërtetë, siç kam treguar në një artikull të fundit,<sup>7</sup> gjithë programi i Syriza-s është thurur mbi hamendësimin se ajo do të fshijë gjysmën e borxhit të Greqisë. Sidoqoftë, pas zgjedhjeve, Varoufaki shtoi një përmasë tjetër: “inxhinieri për borxh të zgjuar” sesa një anulim të drejtpërdrejt të një pjese të borxhit të huaj prej €315 miliard.<sup>8</sup>

<sup>5</sup> What taxpayer bailouts? *Reuters*, May 2, 2013.

<sup>6</sup> 26 Jan 2015.

<sup>7</sup> Syriza’s victory in Greece to add instability to European economy, *Pravda Ru*, 26.01.2015.

<sup>8</sup> Yanis Varoufakis, Greek finance minister, *FT*, February 6, 2015.

Në fjalë të tjera, ristrukturim të borxhit; tepërcia fiskale shumë më të vogla se sasia drakoniane prej 4.5 për qind ose më shumë që kërkon Memorandumi ekzistues; dhe reforma të gjera strukturore, duke përfshirë reformë radikale për mbledhjen e taksave.<sup>9</sup> Ndërsa ai është ende duke kërkuar një analizë radikale dhe plotë mprehtësi për të shpëtuar Europën,<sup>10</sup> përgjatë bisedimeve me “partnerët” e tij Varoufaki në një kollonë në *N. Y. Times*, refuzoi variantin e marrjes së më shumë borxheve, pa një ‘plan të besueshëm për rritjen e ekonomisë’,<sup>11</sup> duke sugjeruar se, ‘Banka Qendrore Europiane duhet të blejë një aset të vetëm në tregjet dytësorë: bonde Bankar Investitues Europian,<sup>12</sup> një qasje që nënkupton përjashtimin e bankave kombëtare nga sistemi bankar. Kjo qasje përputhet me propozimet e “ekonomistëve” ortodoksë. Ajo përjashton, rrjedhimisht, bondet qeveritare dhe shpërnjeh faktin se “lehtësimi monetar” në eurozonë filloi në kushte të papërshtatshme. Sepse ‘synimi i saj është përparimi i përqindjeve negative të interesit dhe interesave negative të bondeve përgjatë kontinentit. Kjo nuk ndodhi në SHBA dhe Britani sepse vendet kishin deficite të mëdha kur Banka Qendrore e Amerikës dhe Banka e Anglisë filluan programet e tyre respektive blerëse. Atje kishte më shumë se mjaftueshëm bonde për të mbajtur interesat e bondeve pozitive. Në eurozonë, ndryshe nga kjo situatë, lehtësimi ekstrem monetar përballet me ortodoksinë fiskale. Rezultati: bondet e eurozonës janë aq të pamjaftueshëm saqë investitorët paguajnë për privilegjin e huadhënies së qeverive.<sup>13</sup>

Nuk do të ishte e çuditshme që qoftë edhe analistë të ekonomisë jo-ortodokse t’a konsiderojnë “ekonominë” e Syriza-s si “ekonomi vuduiste”, domethënë, besimi se duke shkapërderdhur shpenzimet ato do të shpërblejnë vetë, nëse ato shtyhen me energji të mjaftueshme dhe vendosmëri’.<sup>14</sup> Pa përmendur këtu qendrimet naive të Kostas Lapavitsas, një figurë tjetër e Syriza-s, i cili “beson” se Europa mund të ndryshojë nga brenda!<sup>15</sup> Në të vërtetë, ‘qeveria ndahet në tre kampe. Kampi i parë, i cili përfshin Panajot Llafazanin, ministri i energjisë dhe mjedisit, i cili do të ishte i lumtur për Greqinë që të braktiste eurozonën dhe të kthehesh te dhrahmia. Kampi i dytë, në të cilin Janis Varoufakis është kryesori, dhe disa këshilltarë të Cipras, përlllogarsin se partnerët Europian të Greqisë do të pipiliten të parët, duke iu ofruar kushte që do të lejojnë qeverinë e SYRIZA-s për të qendruar në eurozonë dhe për t’a vendosur në një kuadër të ri propagandistik, për opinion publik vendor, si një fitore. Grupi i tretë, i cili qendron afër Janis Drasakis, kryeparlamentarit, mbështet marrëveshjen me kreditorët e Greqisë’.<sup>16</sup>

---

<sup>9</sup> Greece should bail-in the eurozone, *FT*, Feb 06, 2015.

<sup>10</sup> How I became an erratic Marxist, *The Guardian*, 18 February 2015.

<sup>11</sup> Yanis Varoufakis: no time for games in Europe, *N. Y. Times*, Feb. 16, 2015.

<sup>12</sup> On the consequences of Mr Draghi’s impending QE announcement, *The Economist*, Jan 20th 2015.

<sup>13</sup> Europe’s debtor paradise will end in tears, *John Plender, FT*, April 14, 2015.

<sup>14</sup> Syriza and voodoo economics, *Gideon Rachman, FT*, Jan 29, 2015.

<sup>15</sup> Syriza has bold solutions to the forces of austerity that are strangling Europe, *The Guardian*, 2 February 2015.

<sup>16</sup> Greece: Decision time, *FT*, April 17, 2015.

Më në fund, siç zbulon një raport,<sup>17</sup> Syriza nënshkroi një marrëveshje pa u përpjekur fare për “negociata të ashpra”, siç kishte premtuar, për shtrirjen në kohë të programit të shpëtimit nga jashtë duke braktisur premtimin parazgjedhor për shkatërrimin e shpëtimit aktual, qethjen e nivelit të borxhit dhe humbi qoftë edhe autoritetin e saj për të përdorur fondin e shpëtimit të eurozonës prej €10.9 miliard në bonde për rikapitalizimin e bankave: tani, ai do të kontrollohet vetëm nga autoritetet e eurozonës...duke lënë vendin nën të njëjtin diktat: të “trojkës”, e cila është transformuar një “institucion” i përhershëm, duke zëvendësuar Memorandumet aktualë me Memorandume pseudo-kosuesiale!<sup>18</sup> Nga kjo marrëveshje Syriza u zotua se do të vazhdojë të administrojë tepërica buxhetore primare (pagesa përpara interesit mbi borxhin e saj) prej 3 për qind dhe 4.5 për qind në vitin 2016 — një kërkesë nga kreditorët me qëllim që të krijojnë hapësirë për pagesat e interesit që fillojnë në vitin 2023. Në fjalë të tjera, ajo do të vazhdojë politikën e kursimit! Në nivelin politik dhe gjeopolitik, qeveria e SYRIZA-s, siç u pa me vizitën e Cipras, Kryeministrit të Greqisë, në Moskë, Greqia nuk mund të presë shumë, pavarësisht faktit se Rusia është e hapur për projekte të mëdhenj për Ballkanin.

Si përfundim, SHBA, Britania dhe Europa, nuk mund të ndryshojnë nga brenda. As mund të ndryshojnë ato vende nga parti “nacionaliste” (Ukip etj.). As mund të ndryshojnë ato duke ndjekur “opinionet” e ekonomistëve ortodoksë, pavarësisht se ata besojnë se janë “ekspertë”, siç është Krugman, i cili mbështet qasjen e përgjithshme të së “Majtës” Europiane, siç bën Stiglitz, dhe ylli i ri i “ekonomisë” botërore, Piketty, i cili, midis moskuptimeve të tjera, beson se ‘ne kemi nevojë për një ekonomi demokratike dhe progres social’ në nivel Evropian, dhe ‘ne kemi nevojë të demokratizojmë institucionet europiane’...me qëllim që të krijojmë një ‘formë të re autoriteti demokratik publik, të tillë që të zëvendësojë shtetin kombëtar’<sup>19</sup>...se shkaku kryesor i krizës aktuale në Europë janë “politikën e kursimit” që janë imponuar mbi anëtarët e saj.<sup>20</sup> Sepse shkaku kryesor, siç ka treguar bindshëm Takis Fotopoulos,<sup>21</sup> është integrimi i vendeve në BE dhe G/N (OBT etj.).

Qoftë edhe nëse ne konsiderojmë Gjermaninë, qendrën e ekonomisë Europiane, ajo ka krijuar stivën e **borxhit** më të madh **kontigjent** në BE, i cili qendron në një priqindje masive prej 145 për qind të PBB-së. Për këtë lloj borxhi sektori publik nuk është ende i detyruar t’a shlyejë zyrtarisht, por mund të fillojnë në të ardhmen.<sup>22</sup> Ajo ka krijuar, për më shumë, kushtet për krizën tjetër në sektorin e “sigurimeve të jetës”.<sup>23</sup> Kjo s’do thotë, sigurisht, se Gjermania nuk administron një tepëricë në llogarinë rrjedhëse të saj: sepse

---

<sup>17</sup> How Jeroen Dijsselbloem did the deal to extend the Greece bailout, *FT*, March 1, 2015.

<sup>18</sup> Shih për më shumë, The bankruptcy of Syriza and of the globalist ‘Left’, *Takis Fotopoulos, Pravda Ru*, 01.03.2015.

<sup>19</sup> Reforming Europe: Thomas Piketty meets Pabolo Iglesias, *openDemocracy*, 20 February 2015.

<sup>20</sup> The long-run cop-out, *Paul Krugman, N. Y. Times*, Feb. 2, 2015.

<sup>21</sup> A major turning point in Greece for better or worse, *Pravda Ru*, 29.01.2015.

<sup>22</sup> Does Germany have a bigger public debt problem than Greece? *FT*, Feb 11 2015.

<sup>23</sup> Germany’s life insurers: the next crisis? *FT*, April 20, 2015.

siç tregon një analizë,<sup>24</sup> 'të gjithë vendet veriore Europiane me një gjuhë Gjermane administrojnë tepërica në llogarinë rrjedhëse. Përnjimend, Holanda, Zvicra, Suedia, dhe Norvegjia administrojnë tepërica që janë më të mëdha si një përqindje e PBB-së se i Gjermanisë'. As mund të shpëtohen vendet perëndimore nga analizat naive të Zizek, "komunisti" i Elitës Mbikombëtare, ose nga Çomski, "anarkisti" i të njëjtës elitë, meqëse ata nuk kuptojnë ndryshimet sistemike në RRB të G/N krahasueshmërisht me politikat e konsensusit social-demokrat. Bota perëndimore përgjithësisht mund të shpëtojë vetëm nga ato organizata politike të cilat përqafojnë një Projekt politik dhe filozofik ndërsa ngrejnë fronte popullore për çlirim kombëtar dhe social,<sup>25</sup> i cili duhet të promovohet nga Rusia, me qëllim që të shpëtojmë botën dhe jetën e planetit...

Kështu, sektori më i rëndësishëm britanik, sektori financiar, megjithëse filloi me plan shtetëror dhe në periudhën statistike (1960), për të pushtuar, rrjepur dhe kolonizuar botën, ai tashmë është privatizuar dhe nuk i kthen fitimet në Britani — me qëllim që të vilen edhe taksat përkatëse dhe kështu të rritet buxheti i qeverisë Britanike, por i shpërndan ato në "parajsat" e kapitalit. Kjo dukuri tashmë ka marrë përmasa gjigande dhe bankat dhe korporatat botërore ndërsa operojnë në nivel blloqesh ekonomik - fitimet i fshehin jashtë blloqeve. Nuk do të ishte e çuditshme që pas shpërthimit të krizës financiare në vitin 2007, rënia ekonomike në 10 ekonomitë e zhvilluara në Perëndim u shoqërua me rënien e vlerës së aksioneve për të gjitha ekonomitë, duke shkuar në nivelin më të ulët në vitin 2009. Pas vitit 2009, dhe pas ndërhyrjeve qeveritare në sistemin bankar, ekonomitë bashkë me aksionet filluan ngritje graduale, dhe viti 2010, shënoi kohën kur ekonomitë bashkë me aksionet filluan rritje graduale, duke u 'bigëzuar' në mes të vitit 2013, kur, ndërsa aksionet fitojnë vlerë - ekonomitë janë në rënie.<sup>26</sup> Kjo do të thotë se investitorët blejnë aksionet pavarsisht luhatjeve të tregut. Dhe kjo, sepse ata e kanë kuptuar se qeveritë do të shpëtojnë korporatat, sigurisht, me pará publike dhe, presin më shumë fitime nga korporatat sesa nga bondet qeveritare. Për më shumë, kjo prirje do të thotë se pushteti ekonomik zhvendoset për herë dhe më shumë në sektorin privat — një sektor që operon në nivel botëror — dhe lë qeveritë në furtunën e borxheve.

Sigurisht, "eurokratët", siç kam analizuar në vend tjetër,<sup>27</sup> nuk qendrojnë aspak pas homologëve anglo-amerikanë: ata shijojnë rroga marramendëse ndërsa masakrojnë popujt e periferisë. Krugman, në anën tjetër, duke qenë se nuk shqetësohet për shkaqet përfundimtarë të krizës, përtej, sigurisht, "lakmisë kapitaliste" dhe "derregullimit financiar",<sup>28</sup> që është një qasje tejet e pjesshme, propozon, në kuadrin aktual, krijimin e

---

<sup>24</sup> The German Scapegoat, Daniel Gros, *Project & Syndicate*, DEC 5, 2013.

<sup>25</sup> The imperative need for popular fronts of national and social liberation in the globalization era. Takis Fotopoulos, *The International Journal of Inclusive Democracy*, Vol. 10, Nos. 1/2 (Winter-Summer 2014).

<sup>26</sup> Burimi, *Business Insider*. Grafiku përkatës.

<sup>27</sup> Blloqet ekonomik dhe paravërsia e kombeve, dhe Demokraci apo barbarizëm?

<sup>28</sup> This Age of Bubbles, Paul Krugman, *New York Times*, August 22, 2013. Siç citon Krugman: 'Fajtori i qartë është derregullimi financiar – jo vetëm në SHBA por edhe rreth botës, dhe duke përfshirë heqjen e pjesës më të madhe të kontrolleve në lëvizjen

një klase të mesme “me hapa më të vegjël”! Në anën tjetër, Joseph Stiglitz, Nobelist në ekonominë ortodokse, megjithëse bën një përpjekje të mirë kur pranon se pabarazia ka filluar në Amerikë —që është një zgjedhje objektive (politike) sesa subjektive (popullore), e cila ka filluar të përshpejtohet pas vitit 1980, dhe se barazia në nivel botëror është përmirësuar shumë pak (koeficienti “Gini” për shembull, që mat pabarazisë, tregon se nga viti 2002-2008 pabarazia është përmirësuar me 1.4 pikë)— sot, në globalizmin neoliberal, ajo është më e pabarabartë se kurrë, kryesisht midis shtetesh sesa brenda shtetesh, ndërsa nuk shqetësohet me shkaqet - propozon masa sipërfaqësore. Për shembull, ‘pabarazia’, sipas tij, ‘nuk është një fuqi e pashmangshme e pasojave ekonomike. Pabarazia është rezultat i politikës dhe politikave jo vetëm rezultat i ekonomisë...arsyeja se përse pabarazia po përkeqësohet, sipas tij, është se globalizmi nuk ka rregullime. Për të njëjtën arsye ai mbështet rregullime dhe reforma mbi institucionet botërore ndërkohë që mbështet nismën eurozotike sepse Amerika nuk mund t’a ndihmojë botën. Por Amerika këtë nismë e pengon’.<sup>29</sup> Për Stiglitz, rrjedhimisht, pabarazia shikohet vetëm në terma politik dhe ekonomik por jo si pasojë e kuadrit modern institucional!

Kështu, ndërsa vendet perëndimore —me përjashtim të Japonisë e cila ndan disa karakteristika ndryshe nga blloqet ekonomik perëndimor<sup>30</sup>— përmbytin njërin kat, hipin në katin tjetër për të shpëtuar, dhe kur të mbarojnë katet, përmbytja do të jetë me siguri e përbotshme. Ndërkohë, Rusia me Kinën, siç duket, do të ruajnë qëndrueshmëri në afatmesmë. Shkurt, siç citon John Weeks, një ekonomist ortodoks në pension dhe profesor në Universitetin e Londrës, SOAS:

*Në SHBA përplasja midis Partisë Republikane një krahu të djathtë të mirë financiar dhe Partisë Demokratike të moderuar dominon politikën, njëra doktrinare dhe agresive, tjetra e çoroditur dhe ngurruese. Orientimi antidemokratik demonstron me kalimin e ligjeve që kufizojnë të drejtën e votës në shtetet e kontrolluar nga Republikanët, masa që zakonisht lidhen me racizmin dhe ksenofobinë e Partisë së Punës së Lehtë (Tea Party). Në Shtëpinë e Bardhë ulet një Demokrat që siç duket nuk shqetësohet nga kompleksi masiv dhe intruziv (furacak) i sigurisë kombëtare. Nuk është më pak shqetësues sundimi i lirë i Kryeministrit Stephen Harper në variantin e Kanadasë të Administratës Kombëtare të Sigurisë së SHBA-së, CSEC (Communication Security Establishment Canada). Në Europë rrymat anti-demokratike janë më shumë se çdo gjë tjetër në fuqi. Britania ndoshta ka rrjetin më të madh të mbikqyrjes me video në Europë, gjithashtu dhe shtrëngime ligjore në të drejtën e protestave, që janë hartuar për të reduktuar protestat publike (siç shohim në Spanjë). Për më shumë, sulmi brutal e qeverisë së Koalicionit që dominohet nga*

---

ndërkombëtare të kapitalit. Bankat u egërsuan në zemër të flluskës tregëtare të pasurive të patundshme të vitit 1980 njëlloj si flluska e banesave në 2007. Rrjedhje përgjatë kufijëve të parave të nxehta ishin në zemër të krizës së Azisë të vitit 1997-98 dhe kriza që tashmë shpërthen në tregjet në rritje – dhe ishin qendror në krizën e vazhdueshme të Europës, gjithashtu. Shkurt, mësimi kryesor nga këto flluska epokale — një mësim se India, Brazili, dhe të tjerë janë duke mësuar edhe një herë — është se kur industria financiare lirohet për të bërë gjënë e saj, ajo hidhet nga kriza në krizë...

<sup>29</sup> Joseph E. Stiglitz, WRR-Lecture 2014, *The Future of Globalization*.

<sup>30</sup> Shih për më shumë, *Ylli Përmeti*, Blloqet ekonomik dhe pavarësia e kombeve.

*Konservatorët mbi familjet e varfëra që merrnin mbështetje sociale në të vërtetë ligjëroi dhunimin e të drejtave civile, gjithashtu dhe turpin e përbashkët. Vrojtimit, sulmi mbi të varfërit dhe ndezja e frikërave qeveritare për emigrantët ndërthuren për të krijuar një paketë të fuqishme anti-demokratike.<sup>31</sup>*

BE-ja, në anën tjetër, me veton e Komisionit European, siç propozoi në ligjëratën e tij mbajtur në Ambasadën Gjermane në Londër, kandidati gjerman për kancelar, Peer Steinberg, mbi buxhetet kombëtare, se nëse anëtarët tejkalojnë udhëzimet e paketës fiskale, synon, sipas tij, **dorëzimin e sovranitetit kombëtar**, pavarsisht se popujt përkatës nuk do të kenë mundësi të ushtrojnë presion mbi qeveritë e tyre për përgjegjshmëri! Në fjalë të tjera, qëllimi i “stabilitetit fiskal” kërkon nga qytetarët e Evropës të dorëzojnë të drejtën e tyre bazë demokratike për të mbajtur një qeveri të përgjegjshme për politikën e saj ekonomike. Kjo është përmbushja e axhendës së G/N: heqja nga kontrolli demokratik i të gjitha politikave kryesore ekonomike!<sup>32</sup> Siç citon Weeks, sërish, kur citon një tjetër ekonomist ortodoks britanik të pas luftës së dytë botërore (1947), nga *The Economic Journal*, K. W. Rothschild:

*Kur ne hyjmë hapësirën e rivalitetit midis gjigandëve [të korporatave], ndarja tradicionale nga politika në ekonomi nuk mund të mbahet...Fashizmi...është ngritur kryesisht në pushtet nga kjo betejë në një përpjekje të oligarkëve më të fuqishëm për të forcuar, përmes veprimtarisë politike, pozicionin e tyre në tregun e punës krahasuar me konkurrentët e tyre më të vegjël, dhe përfundimisht shpërthejnë me qëllim që të ndryshojnë gjëndjen e tregut në interesin e tyre.<sup>33</sup>*

Në nivel botëror, nga viti 1988 në vitin 2008, 1% i majës botërore panë të ardhurat e tyre të rriten me 60 për qind, ndërsa ata në fund nuk kishin ndryshime në të ardhura. Dhe ndërsa të ardhurat mesatare janë përmirësuar në dekadat e fundit, atje është ende një pabarazi tejet e madhe: 8 për qind e njerëzimit çon në shtëpi 50 për qind të të ardhurave botërore; vetëm maja e 1 për qindshit çon në shtëpi 15 për qind nga të ardhurat botërore!<sup>34</sup> Kjo dinamikë, e përfitimit dhe konkurrencës, dominimit dhe robërimit, zhvillohet në nivel shtetëror, sepse në nivel mbikombëtar, oligarkët, ndajnë kombet dhe ‘ndërvarësia’ dominon konfliktin.<sup>35</sup>

\*Ky sudim është publikuar në një variant më të shkurtër në *Pravda. ru*, në anglisht dhe është shkëptur nga një studim më i gjerë me titull, *Bota Perëndimore lëvizë drejt ekofashizmit të organizuar*, pjesët e të cilit do të publikohen së shpejti.

---

<sup>31</sup> Neoliberalism and the Decline of Democracy, *Porf. John Weeks, Global Research*, March 27, 2014.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> Inequality Is a Choice, *JOSEPH E. STIGLITZ, N. Y. Times*, October 13, 2013.

<sup>35</sup> Shih për më shumë rreth komentatorëve mbikombëtar, *Demokraci apo barbarizëm?*

[http://english.pravda.ru/world/europe/29-04-2015/130410-greek\\_bail\\_out\\_western\\_world-0/](http://english.pravda.ru/world/europe/29-04-2015/130410-greek_bail_out_western_world-0/)